



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:228589
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05536863

Ac.nr.682/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ndërmarrja Publike Komunale “T”, kundër të paditurit E.R, për pagesë qiraje, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2115/13 e datës 10.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25/03/2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e të paditurit E.R dhe PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2115/13 e datës 10.11.2020, dhe lënda kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin ankimor C.nr.2115/13 e datës 10.11.2020, ka vendosur si vijon:

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Ndërmarrja Publike Komunale “T”, SI E BAZUAR.

II. DETYROHET i padituri E.R, që paditësit, Ndërmarrja Publike Komunale “T”, që në emër të borgjit sipas Marrëveshjes mbi qiradhënie nr. 65/10 e dt. 10.06.2010 t’i paguaj shumën prej 340.00€, me kamatë ligjore të llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë 30.08.2013, deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të permbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Paditësja ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e të paditurit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 30.08.2013, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për pagës të qirasë, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin për shkak padëgjushmërisë-mosbindjes duke aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se i padituri në afatin e paraparë ligjor, nuk ka paraqitur përgjigje në padi dhe themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe faktet e treguara në kërkesëpadi janë të mbështetura me provat e propozuara si Marrëveshja e Qiradhënies nga e cila vërtetohet se i padituri ka qenë i obliguar që të paguaj paditësit shumën prej 340.00€, në afat prej 15 ditësh, por obligimin nuk e ka kryer, nga këto arsye gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit duke u bazuar në nenin 150.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika i) e lidhur me nenin 110 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit e Kosovës, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të sipër theksuara, për arsye se të paditurit nuk ia ka dhënë mundësin e shqyrtimit të çështjes në gjykatë, gjegjësisht nga shkresat e lëndës rezulton se aktvendimi i datës 25/05/2015 nuk ju është dorëzuar të paditurit personalisht, por këtë aktvendim e ka pranuar M.R të cilës nuk ju dihet lidhja familjare me të paditurin. Sipas nenit 110 të LPK-së ligjvënësi ka paraparë: *Padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t'i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar.* Andaj, shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në riprocedurë duhet të eliminohen dhe pasi vlerësimit të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, të vendosë në mënyrë meritore për themelësinë e kërkesëpadisë duke nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:228589
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05536863

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.682/21, me datë 25/03/2024

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Liridon Maloku